



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH. nr. 617/19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të : z. Goran Milenković - Kryetar z. Nuhi Paçarizi – Referues z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “ENGROUP” SHPK - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: NTP “Ulpiana” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Fasadimi dhe gëlqerosja në shkolla dhe objekte tjera Komunale Lot - 1” me nr prok: 616-19-3413-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ –Kuvendi Komunal Prishtinë, më datën 10.10.2019 mori këtë :

**V E N D I M**

**I. HEDHET**, si e jashtë afateshme ankesa e operatorit ekonomik “ENGROUP” SHPK - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Fasadimi dhe gëlqerosja në shkolla dhe objekte tjera Komunale Lot - 1” me nr prok: 616-19-3413-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ –Kuvendi Komunal Prishtinë, pasi që e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së, si dhe nenin 4 pika ( b) Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave

**II. I LEJOHET**, autoritetit kontraktues / Kuvendi Komunal Prishtinë /, që të vazhdojë më tutje me procedurat e prokurimit me titull: “Fasadimi dhe gëlqerosja në shkolla dhe objekte tjera Komunale Lot - 1” me nr prok: 616-19-3413-511, (nëse nuk ka ankesë tjetër).

**III.** Pasi që ankesa e Operatorit Ekonomik ankues hedhet si e jashtë afateshme dhe se e njëjta nuk është shqyrtuar nga ana e panelit shqyrtues, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës, në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 22.05.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 02.08.2019

Data e njoftimit me letër standarde është bërë me dt: 11.09.2019

Data e fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 20.06.2019

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 20.06.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 06.08.2019.

Data e njoftimit mbi vendimin e AK-së është bërë me dt: 02.08.2019

Data e vendimit të AK –së, lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 13.08.2019.

Operatori ekonomik ankues: “ENGROUP” SHPK - Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me datën: 19.09.2019 me nr. 617/19, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Fasadimi dhe gëlqerosja në shkolla dhe objekte tjera Komunale Lot - 1” me nr prok: 616-19-3413-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë (KKP), duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 59, 60, 69, 72, 108/A të LPP-së, dhe nenin 39.8 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 23.09.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 01.10.2019, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues: “ENGROUP” SHPK - Prishtinë, në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:



Me datë:11.09.2019. përmes Letrës standarde për tenderuesin, AK-së, i njofton të gjithë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit: “Ju informojmë se kontrata i është dhënë OE NTP “ULPIANA” - Prishtinë , me çmim prej: 162,870.00 €, për Lot 1. Eksperti shqyrtues sqaron se me datë:11.09.2019, OE ankues “ENGROUP” SHPK – Prishtinë,përmes Letrës standarde për tenderuesin, është njoftuar se është tenderues i suksesshëm, mirëpo për kontratë është rekomanduar OE NTP “ULPIANA” - Prishtinë , me çmim prej: 162,870.00 €, për Lot 1. Duke u bazuar në dëshmitë eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues “ENGROUP” SHPK – Prishtinë, nuk ka vepruar konform nenit 4 Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, konkretisht nuk është respektuar “Periudha kohore për dorëzimin e një kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues”.

Në nenin 4.1 pika b) thuhet: Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme: “Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit”.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues “ENGROUP” SHPK – Prishtinë, nuk ka vepruar ashtu siç parashihet në nenin 4, nuk e ka shfrytëzuar “Periudha kohore për dorëzimin e një kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues”, pas njoftimit me Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm dhe njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, por direkt ka ushtruar ankesë pran OSHP-së.

Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa lejuar (sepse nga OE ankues nuk është shfrytëzuar afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim pran AK-së, pra nuk është parashtruar kërkesë për rishqyrtim) të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin për dhënie të kontratës.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës 02.10.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 01.10.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10.10.2019, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE ankues, përfaqësuesit e AK-së, si dhe eksperti shqyrtues, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës



duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Zekaj deklaroj: Ne si OE se pari nuk pajtohemi me mendimin e Eksperti Shqyrtues por edhe me vlerësimin e panelit këtu për shkak, paraprakisht vlerësojmë se kërkesën sipas ligjit për rishqyrtim e kemi bërë tek Autoriteti Kontraktues por që Autoriteti Kontraktues na ka privuar nga e drejta që të kemi qasje në dokumentet zyrtare që është shkelje e LPP-së dhe legjislacionit dytësor nën 10 paragrafit 3 dhe 5 si dhe nën 7.4 të U Rregullativ. Kërkesën për rishqyrtim ne e kemi bërë dhe ne të Autoriteti Kontraktues e ka vlerësuar se ethe pjesërisht e bazuar dhe në bazë të saj e ka bërë rivlerësimin e tenderit në rivlerësim Autoriteti Kontraktues e ka shpallur fitues prapë të njëjtin OE , në për shkak se Autoriteti Kontraktues në kërkesën tone pjesërisht të bazuar ka vlerësuar se Komisioni ka bërë shkelje në disa raste të cilat shkelje nuk ka mundur të sqarohen as me kërkesë për sqarim shtesë për shkak se është në kundërshtim me ligj por që ne si OE kemi dashur që ta vlerësojmë dhe sqarojmë me anë të qasjes se si është e mundur që kërkesa për rishqyrtim të është e bazuar dhe prapë të shpallet fitues i njëjti OE. Në brenda afatit kemi kërkuar qasje në Dokumente zyrtare të cilat përgjigje i kemi dorëzuar tek Eksperti Shqyrtues me e-mail, ndërsa njoftimi na është dërguar me datë 19.09.2019 ne kemi kërkuar qasje me 13.09.2019 ndërsa Autoriteti Kontraktues na kthen përgjigje me datën 16 po ne të njëjtën ditë qasjen na ofron në fund të orarit të punës, NE si OE e vlerësojmë se Autoriteti Kontraktues qëllimshëm na ka privuar nga e drejta ligjore që të kemi qasje në Ofertën të cilën ata e kanë shpallur përsëri fitues, prandaj ne si OE e kemi vlerësuar se një kërkesë e re për rishqyrtim ka qenë e pamundur të bëhet në afatet që Autoriteti Kontraktues na ka ofruar përkundrazi ne nuk kemi pasur asnjë mundësi që të bëjmë një kërkesë dhe përfundimisht na kanë pamundësuar të drejtën tone ligjore. Si OE kemi një pyetje për të gjithë si mund të bëhet një kërkesë për rishqyrtim për të njëjta shkelje të cilat AK i ka vlerësuar si të bazuara dhe ligjërisht nuk kanë mundur të evitohen me sqarim dhe në afat pothuaj se 10 min? Pretendimet tona të cilat nuk janë shqyrtuar fare kanë qenë me menaxherin e projektit dhe udhëheqësin e punishtës të cilat Autoriteti Kontraktues ka thënë se Komisioni është dashur të trajtoj site pranueshme për OE-n e shpallur fitues sepse CV-ja e tyre nuk i ka plotësuar kërkesat e Autoritetit Kontraktues. Gjatë rivlerësimit Autoriteti Kontraktues këtë pretendim tonin si duket e ka anashkaluar dhe prapë e ka pranuar si të tillë nga OE i shpallur fitues. Me këtë Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje ligjore sepse është dashur të eliminoj në bazë të nenit 31.8 të RrUOPP-së. Pretendimi tjetër ka qenë me Udhëheqësin e punishtës ku OE i rekomanduar nuk ka ofruar asnjë ING dhe të cilin Autoriteti Kontraktues nuk e ka trajtuar fare, përkundër pretendimeve tona ne nuk kemi pasur mundësi të vlerësojmë se si është bre rivlerësimi i ofertave nga vet fakti se na është mohuar e drejta ligjore për qasje në dokumente zyrtare. Prandaj edhe kemi qenë të detyruar të drejtohem i OSHP-së duke shprehur se shkeljet ligjore



te Autoritetit Kontraktues do te evitohen dhe vendimi për rekomandimin e kontratës te anulohet dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Isufi deklaroj: OE ankues ENGROUP është e vërtetë që ka kërkuar qasje me datën 13.09.2019 dhe ju është ofruar qasja te vije me datën 16.09.2019 ne ora 09 për orën 11 dhe OE nuk është përgjigjur fare dhe unë e kam e-mailin që me datën 17 i kam kërkuar se pse nuk është kanë ne qasje a e keni pranuar e-mailin dhe mandej po atë dite i kam thënë te vije ne qasje ne ora 14, ne qasje ka qenë edhe ne herën e pare te vlerësimit kështu që nuk është e drejtë që nuk i është ofruar qasjen zyrtare. Pajtohemi me mendimin e Eksperti Shqyrtues se OE ankues nuk e ka shfrytëzuar afatin ligjor prej 5 ditëve që te parashtroj kërkesë tek Autoriteti Kontraktues, por ka bërë ankese ne OSHP, është ngritur me 19.09.2019

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Muhadri deklaroj: Sa i përket pretendimit te OE ankues pretendimeve ne lidhje me parregullsitë e komisionit vlerësues konkretisht Menaxherit Udhëheqësit te punishtes mendoj se përgjegjësia bien mbi Autoriteti Kontraktues mirëpo duke u bazuar ne LPP OE ankues nuk e ka ushtruar te drejtën e vete për te bre kërkesë për rishqyrtim brena afatit ligjore pran Autoritetit Kontraktues ku dhe me herët edhe vet OE ankues deklaroj se si te behet prapa kërkesë për rishqyrtim për pretendime te njëjta po e pranon se nuk ka bre kërkesë për rishqyrtim kjo ka qenë arsyeja pse nuk jam lëshuar ne pretendime ankimore dhe kam rekomanduar te hidhet poshtë ankesa dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Zekaj deklaroj: Sa i përket mendimit te ekspertit shqyrtues tani ne si OE nuk thamë se nuk e kemi bërë kërkesën por këtë deklaratë e kemi pas te gjitha përpjekjeve për te pasur qasje ne dokumente te cilat na janë mohuar ne nuk kemi pasur rruge dalje tjetër vetëm ti drejtohem OSHP-së por pretendimet e njëjta te cilat që i kemi bërë për herën e dyte nuk kemi pasur qasje dhe nuk kemi ditur te beje ankese, ndërsa sa i parkete Autoritetit Kontraktues deklaratave te Autoritetit Kontraktues se është e vërtet se na kanë dhënë qasje sipas saj sepse njoftimi është dërguar me date 11.09.2019 kërkesa është bërë me date 13.09.2019, ndërsa përgjigja është kthyer me datën 16.09.2019, ne ora 11:36 e jo ne ora 09:00, qasja na është dhënë ne ora 14 që është dita e fundit, nuk është e drejtë te mendohet nga askush se një OE mund te këtë qasje ne Autoriteti Kontraktues ne ora 14 dhe për 2 ore ti përfundoj te gjitha përgatitjet për te kërkuar kërkesë për rishqyrtim ne mendojmë koha që na është dhënë nuk ka qenë e mjaftueshme. Deri sa te shkojmë ne Autoriteti Kontraktues dhe te kthehemi ne Autoriteti Kontraktues.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Isufi deklaroj: Kërkojmë te hidhet poshtë ankesa e OE dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.



Paneli shqyrtues, pas verifikimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, konstaton se OE “ENGROUP” SHPK - Prishtinë, nuk ka vepruar konform nenit 4 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP, dhe vlera e tarifave të ankesave, konkretisht nuk është respektuar “Periudha kohore për dorëzimin e një kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues”.

Në nenin 4.1 pika b) thuhet: Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme: “Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit”.

Paneli shqyrtues, sqaron se OE ankues “ENGROUP” SHPK – Prishtinë, nuk ka vepruar ashtu siç parashihet në nenin 4, nuk e ka shfrytëzuar “Periudha kohore për dorëzimin e një kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues”, pas njoftimit me Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm dhe njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, por direkt ka ushtruar ankesë pranë OSHP-së.

Prandaj paneli shqyrtues vjen në përfundim se operatori ekonomik ankues “ENGROUP” SHPK - Prishtinë, e ka lëshuar afatin ligjor për “Periudha kohore për dorëzimin e një kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues, dhe si ankesë e tillë drejtuar në OSHP, nuk mund të shqyrtohet nga ana e panelit shqyrtues.

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković

#### **Vendimi t’i dorëzohet:**

- 1x1 AK– Kuvendi Komunal Prishtinë
- 1x1 OE- “ENGROUP” SHPK - Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.